



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 986 / Prot.

Tiranë, më 31 10 2016

2

REKOMANDIM

Nr. 23 datë 31 10 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit, Hotel "Brilant Antik" Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person fizik,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.202, datë 20.09.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "Brilant Antik" p.f. sipas procedurave administrative me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, masat për sigurinë e të dhënave personale gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, Hotel "Brilant Antik" p.f. Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve proceduriale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr.202, datë 20.09.2016 të Komisionerit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi e ka kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e mbikëqyrjes së ambienteve nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
3. Kontrolluesi aplikon Deklarata Konfidencialiteti bashkangjitur kontratave individuale me punëmarrësit.
4. Kontrolluesi mban një kopje të pasaportës në momentin e regjistrimit të klientit në hotel dhe, në momentin e largimit kjo kopje ose i jepet klientit me vete ose shkatërrohet në moment (griset).

5. Nuk konstatohet që kontrolluesi të ketë ndonjë arshivë elektronike apo fizike, me të dhëna personale të klientëve.
6. Kontrolluesi nuk kryen marketing online (mesazhe promovionale) nëpërmjet postës elektronike apo mesazheve telefonike.
7. Kontrolluesi nuk aplikon politikat e privatësisë në portalin zyrtar: [www.hotelbrilant.com](http://www.hotelbrilant.com).

**Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.**

**Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formular Njoftimi i kontrolluesit *Hotel "Brilant Antik" p.f., Tiranë.*
- Fotografi të ambienteve.
- Ekstrakt i QKR-së.
- Printim nga portali [www.hotelbrilant.com](http://www.hotelbrilant.com).
- Listëpagesa e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, etj.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se do përmbushin konstatimet e dala nga ky proces verbal.

Zyra e Komisionerit konkludon se, kontrolluesi *Hotel "Brilant Antik" p.f., Tiranë* gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij në hoteleri, ka masa të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qënë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe në kuadër të gjetjeve të hasura pranë këtij kontrolluesi,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *Hotel "Brilant Antik" p.f., Tiranë*, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi *Hotel "Brilant Antik" p.f., Tiranë*, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".

3. Kontrolluesi *Hotel "Brilant Antik" p.f.*, Tiranë, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, në vazhdimësi për pikën e parë të këtij rekomandimi dhe, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dalja e tij për pikën e dytë.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 31.10.2016

**BESNIK DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**

*(Faint circular stamp: TIRANË - 2)*